

SHENIME SHPJEGUESE; Per periudhen 1 Janar deri me 31 Dhjetor 2023.

Ne kete aneks paraqiten informacionet shpjeguese ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare te njesise ekonomike Big Roskoveci sh.p.k.

Njesia ekonomike Big Roskoveci sh.p.k e krijuar me date 1.11.2019 ushtron aktivitetin e saj ne fushen Supermarketeve Lagjja Nr. 1, përballë fushës së sportit, Roskovec, Fier. (Adresa).

Per periudhen 01 Janar 2023 deri me 31 Dhjetor 2023 jane pergatitur dhe paraqitur paketa e plote e pasqyrave financiare, te cilat japin pamjen te vertete dhe te drejte te pozicionit financiare, performances financiare dhe fluksit te parase gjate kesaj periudhe.

Pergatitja dhe paraqitja e tyre, e cila eshte pergjegjesi e Drejtimit te subjektit, eshte realizuar mbeshtetur ne Ligjin nr 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit(KKK). Gjuha e perdorur eshte gjuha shqipe. Monedha e perdorur eshte monedha Leke. Rrumbullakime te vlerave nuk ka. Ngjarjet dhe trasaksionet jane evidentuar gjate gjithe periudhes ushtrimore ne perputhje me SKK nr 1 Kuadri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare dhe SKK nr 2 Paraqitja e pasqyrave financiare si dhe cdo standard tjetër kombetar ne perputhje me natyren e ngjarjeve apo trasaksioneve te cilat ne menyre te hollesishme do te jepen ne vijim te informacioneve shpjeguese.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren BILANC.

Paraqitja e kesaj pasqyre eshte mbeshtur ne paketen e plote te standardeve te permiresuara te miratuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Ne vijim do te jepen informacionet shpjeguese per zerat perberes te saj.

I. Informacione Shpjeguese per AKTIVET.

Totali i aktiveve te paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **32,287,129 leke** detajimi nepermjet informacioneve shpjeguese i te ciles paraqitet si vijon;


✚ Informacione shpjeguese te AKTIVE AFATSHKURTRA

Aktiveve afatshkurtra jane paraqitur ne vleren **27,888,293 leke** te cilat jane te perbera nga;

1. Aktive monetare 5,378,312 leke. Ky ze eshte paraqitur ne pasqyre duke u mbeshtetur edhe ne SKK nr 12 *Efektet e ndryshimeve të kurseve të kembimit* dhe paraqet tepricen e llogarise Arka dhe tepricen e llogarise banke, ne monedhen lek dhe euro ne date 31.12.2023. Kursi i kembimit eshte perdorur ne menyre sistematike gjate gjithe ushtrimit te aktivitetit te subjektit per ngjarjet e trasaksionet te cilat jane kryer ne monedha te huaja.

2. Te drejta te arketueshme te cilat jane paraqitur ne vleren **4,608,126 leke** dhe eshte e perbere nga;

Zeri, Nga aktiviteti i shfrytëzimit ne vleren **4,608,126 leke**, i cili eshte evidentuar edhe ne perputhje me SKK nr 3 ne te cilen përfshihen të gjitha të drejtat e krijuara gjate periudhes ushtrimore ndaj



klientave për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm, të paraqitura me vlerën neto të realizueshme.

3. Inventari i paraqitur në vlerën 17,901,855 leke, i cili është i përbërë prej;

Zeri Mallra në vlerën 17,901,855 leke, mallra për rishitje janë njohur dhe vlerësuar në përputhje me SKK nr 4 *Inventaret*. Kostoja e inventarit është vlerësuar me metodën e kostos mesatare të ponderuar

Mallrat e blera gjatë periudhës ushtrimore janë 114,148,850 leke dhe kosto e mallrave të shitur e cila është pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve është 111,470,622 leke.

Informacione shpjeguese të AKTIVET AFATGJATA

Aktivët afatgjatë janë paraqitur në Vlerën Kontabel Neto 4,398,836 leke. Ato janë evidentuar edhe në përputhje me SKK nr 5 Aktivët afatgjatë materiale dhe aktivët afatgjatë jomateriale. Paraqitja e tyre është bërë nëpërmjet politikës kontabel Metoda e Kostos. Përberja e këtij zeri paraqitet si vijon;

1. Aktive afatgjatë materiale janë në vlerën 4,398,836 leke dhe është i përbërë nga zeri

Pajisje Kompjuterike në vlerën 533,187 leke. Metoda e përzgjedhur për amortizimin është metoda mbi vlerën e mbetur, dhe është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën ushtrimore në vlerën 177,729 leke.

Të tjera Instalime dhe pajisje në vlerën 3,865,649 leke. Metoda e përzgjedhur për amortizimin është metoda mbi vlerën e mbetur, dhe është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën ushtrimore në vlerën 938,306 leke.

Ne të janë të përfshirë elementet e mëposhtme;

Nr. Llogarie	Emertimi i Llogarisë	Monedha	Debi	Kredi
2181	<i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	LEK	1,553,988	
2182	<i>Pajisje Kompjuterike,</i>	LEK	8,964,832	
281801	<i>Per Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	LEK		938,306
281802	<i>Per Pajisje Kompjuterike, Pajisje Zyre</i>	LEK		177,729



II. Informacione Shpjeguese per DETYRIMET.

Detyrimet e paraqitura ne pasqyren e Bilancit jane ne vleren **32,287,129 Leke** dhe perbehet vetem nga detyrime te periudhave afatshkurtra. Detajimi jepet nepermjet informacioneve shpjeguese si vijon;

Informacione shpjeguese te DETYRIMEVE AFATSHKURTRA

Detyrimet afatshkurtra jane paraqitur ne total ne vleren **16,551,761 leke**, dhe jane te perbera nga detyrimet ndaj furnitoreve, punonjesve , detyrime ndaj shtetit per tatime dhe taksa.

- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **13,988,512 leke** paraqesin detyrimin e papaguar per blerjen e mallrave nga furnitore te ndryshem te njesise ekonomike ne fund te vitit 2023.

- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore ne vleren **266,249 leke** perbejne vetem detyrimin per pagat e personelit te papaguara deri ne fund te vitit 2023 si dhe detyrimin per sigurimet shoqerore dhe shendetsore per muajin Dhjetor 2023 dhe detajohet si vijon;

Elementi	Ref	Vlera
Sigurime Shoqerore	431	213,567
Tatimi mbi te ardhurat	442	52,682


Numri mesatar i punonjesve per vitin 2023 eshte 15.

- Te pagueshme ndaj detyrimeve Tatimore ne vleren **2,297,000 Leke** paraqesin:

Elementi	Ref	Vlera
Shteti - TVSH per tu paguar	4453	1,550,262
Tatimi mbi fitimin	444	715,154
Tatimi ne burim	449	31,584

III. Informacione Shpjeguese per KAPITALIN

Kapitali i paraqitur ne vleren **15,735,368 Leke** dhe eshte i perbere nga zerat Kapital i nenshkruar, Fitime te Pashperndara dhe Fitim / Humbje e vitit, detajimi i te cilave do te jepet ne informacionet shpjeguese.



1. Informacione shpjeguese te zerit KAPITAL

Ne kete ze jane paraqitur kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët dhe jane përmbledhur tepricat kreditore të llogarive vijuese:

Emertimi	Ref	Vlera
Kapitali i paguar,	101	5,000,000
Totali		<u>5,000,000</u> leke

Ne perputhje me aktin e themelimit date 28.10.2019 kapitali i kontribuar eshte i perbere nga Kuota ose aksione, gjithsej:

1- Shoqeria Big Alb Group Shpk, 1 kuotev, 2.550.000 leke qe perben 51 (%) te kapitalit themeltar .

2- Znj. Mirela Sulaj , 1 kuote, 2.450.000 leke qe perben 49(%) te kapitalit themeltar

2. Informacione shpjeguese te zerit REZEVRA TE TJERA

Zeri *Reverza Ligjore* paraqitet ne vleren totale neto **500,000 leke** dhe perfshine rezerven ligjore te njesise ekonomike.

Zeri Rezerva te tjera ne vleren totale neto **0 leke** dhe perfshine rezervat e tjera qe disponon njesia ekonomike.


3. Informacione shpjeguese te zerit FITIM / HUMBJE E VITIT

Zeri *Fitim / Humbje e vitit* paraqitet ne vleren **10,235,368 leke** dhe paraqitet rezultati i periudhës rrjedhese ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi eshte zbritur tatimi mbi fitimin.

❖ Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren **TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.**

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve eshte paraqitur bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres. Ne kete periudhe ushtrimore ka rezultuar nje fitim ne vleren **10,235,368 leke.**

Zeri Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit te paraqitura ne pasqyre me vleren e tyre neto **139,854,632 leke** evidenton:



Te ardhura nga shitja e Produktit te Mallrave me vleren e tyre neto 135,861,792 leke

Zeri Të ardhura te tjera te shfrytezimit te paraqitura ne pasqyre me vleren e tyre neto 3,992,840 leke evidenton:

Te ardhura nga shitja e Shërbimeve me vleren e tyre neto 3,955,560 leke

Zeri Te Tjera ne vleren 37,280 Leke jane fitim nga kembimi valutor :

Elementi	Ref	Vlera
Fitim nga kembimi valutor	769	37,280

Zeri Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme te paraqitura ne vleren 111,470,622 leke perfaqesojne koston e mallrave te blera per qellime rishitje. Politika kontabel eshte paraqitur me larte ne zerin *Mallra per shitje* (Inventar).

Zeri Shpenzime të personelit i cili eshte i paraqitur ne vleren 9,970,947 leke perfaqeson:

1. Shuma *Paga dhe shpërblime* gjate periudhes ushtrimore 01.01.2023- 31.12.2023 ne vleren 8,569,743 leke
2. Shuma *Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)* gjate periudhes ushtrimore 01.01.2023-31.12.2023 ne vleren 1,401,204 leke

Zeri Shpenzime konsumi dhe amortizimi i paraqitur ne vleren 1,116,035 leke ne pasqyrene te ardhurave dhe shpenzimeve.

Zeri Shpenzime të tjera shfrytëzimi te cilat jane te paraqitura ne vleren 4,929,384 leke perfaqesojne shpenzimet te cilat jane kryer per zhvillimin e aktivitetit te njesise ekonomike, dhe perfaqeson zera te shpenzimeve si furnitura, taksa te ndryshme dhe te tjera.

Zeri Shpenzime të tjera financiare te cilat jane te paraqitura ne vleren 227,732 leke, perfaqesojne shpenzimet per komisionet e bankare , si dhe diferenca negative dhe pozitive nga kurset e kembimit.

Zeri Shpenzimi aktual i tatim fitimit eshte i paraqitur ne vleren 1,904,543 Leke.

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren CASH FLOW.**

Ne pasqyren e flukseve monetare jane paraqitur flukset hyrese dhe dalese te mjeteve monetare në njësinë ekonomike gjatë periudhës korrente kontabël. Paraqitja eshte bere sipas metodes indirekte.

Gjate periudhes kontabel ka rezultuar;



Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit ne vleren **8,935,471 leke**.
Fluksi pozitiv ka ardhur pasi flukset dalese te mjeteve monetare per kryerjen e shpenzimeve si psh, paga, detyrime per kontribute te sigurimeve dhe te tatim-taksave jane me te ulta se flukset hyrese te mjeteve monetare gjate ushtrimit normal te aktivitetit nga njesia ekonomike.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit ne vleren **0 leke** i cili ka ardhur si rezultat i blerjes se aktiveve afatgjate materiale.

Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit ne vleren **-7,223,811 leke** i cili ka ardhur si rezultat i dividendit te paguar dhe huase te paguar

❖ **Shenime shpjeguese ne lidhje me zerat e paraqitur ne pasqyren NDRYSHIMEVE TE KAPITALIT .**

Ndryshimet ne zerin Kapital kane ardhur si rezultat;

1. Fitim / Humbje e vitit ne vleren **10,235,368 leke**.

Informacionet shpjeguese per zerat e mesiperm jane dhene ne pasqyren e Bilancit.

Drejtuesi

MIRELA SULAJ



Hartuesi

KLODJANA ÇEPELE

